


POLITIKAT MONETARE

Adrian Civici
UET



Politikat Monetare

- **Politika Monetare...si instrument i Politikes Ekonomike..... "eshte veprimi nepermjet te cilid....Autoritetet Monetarepergjithesisht... Bankat Qendrore....*ndikojne mbi oferten e parase* ne menyre qe te realizojne objektivin e tyre :**
- ***Stabilitetin e cmimeve / kontrollin e inflacionit***
- ***nxitjen e rritjes ekonomike;***
- ***nxitjen e punesimit;***
- ***permiresimin e bilancit te pagesave....***



*Politikat monetare dallohen nga politikat buxhetore – dhe te dyja bashke formojne ate qe quhet “**mix-policy**”*

Politikat Monetare



- **Objektivat e Politikes Monetare :**
- **Teoria ekonomike :** “*qellimi i bankave qendrore eshte maksimizimi i situates ekonomike e financiare te bizneseve*” (Mishkin).
- **Nga kjo pikepamje kemi 2 objektiva themelore te PM :**
- **1. Stabilizimi i cmimeve...**
- **2. Stabilizimi i aktivitetit ekonomik;**

2 objektivat mund te shikohen edhe si nje i vetem :
aq te lidhur dhe te ndikueshem jane njeri me tjetrin.

Politikat Monetare



- Megjithate... **nuk egziston nje lidhje afat-gjate ndermjet tyre,**
- (*kurba e Philips-it...ne afat-gjate nuk vertetohet lidhja direkte “inflacion-papunesi”*)
- **Objektivi afat-gjate i Bankes Qendrore mbetet STABILITETI I CMIMEVE.....**
- *nderkohe qe rritja ekonomike varet dhe nga faktore te tjere si produktiviteti, stoku i kapitaleve, struktura e ekonomise, kapitali njerezor, etj.*
- **Pikepyetja : a duhet qe bankat qendrore te kene si objektiv edhe “ruajtjen e perqindjes se kembimit te monedhave” ? Apo kjo duhet ti lihet krejtesisht tregut?**

Politikat Monetare

Pak histori :

- Ne shek XIX, objektivat e politikes monetare u bene objekt i dy shkollave te ndryshme
- A. “**Currency school**” ..shkolle e mendimit ekonomik e formuar nga disa ekonomiste britanike te viteve 1810-1850 (*David Ricardo, Henry Thoenton, Roberts Torrens*).....dominoi ne shek.XIX)..trashegimtare e “buillonism-it”, qe e percaktonte pasurine ne raport me sasine e arit – merkantilizmi spanjoll

“ ...inflacioni shkaktohet nga emetimi i tepert i monedhave nga bankat....monedhat e emetuara duhet te jene te barabarta me vleren e arit qe keto banka zoteronin...rregjimi i arit si etalon.....
(KONTROLLI MONETAR)



- **B. “Banking school”...mbronte qendrimin se vlera e monedhave mund te rregullohej ne menyre natyrore nga deshirat e depozituesve ne banke..nese ata donin apo jo ti konvertonin ne ar monedhat e tyre....(LIRIA MONETARE)**
-sipas tyre “**sasia e monedhave ne qarkullim duhet te varej para se gjithash nga nevojat e agjenteve ekonomike.....masa monetare duhet te adaptohet sipas nevojave te biznesit dhe ekonomise.....**

Politikat Monetare

- **Monetarizmi** ... term i shfaqur ne vitin 1960 per te karakterizuar nje shkolle ekonomike sipas se ciles “nderhyrja e shtetit ne fushen monetare eshte e panevojshme...bile e demshme.....
- Perfaqesuesi me i spikatur i saj Milton Friedman...kerkoi te rrikthente teorine sasiore te parase kunder paradigmës dominuese te kohes qe ishte keinsianizmi.
- *Fridmani kerkoi braktisjen e politikave monetare nderhyrese ne treg...sugjeronte caktimin e nje mase monetare fikse qe i korrespondonte nje rritjeje ekonomike mesatare (5%)....dhe lenien e madhesise se perqindjeve te interesit ne funksion te kerkeses dhe ofertes se tregut....e cila kushtezohej nga ecuria e ekonomiserritem i ulet apo rritem i larte i saj....*



■ Tipet e ndryshme te politikave Monetare :

A. Fiksimi i perqindjes se kembimit

- PM mund te kete objektiv “**fiksimin e perqindjes se kembimit te monedhes kombetare me nje ose disa monedha te huaja**” ...Banka Qendrore fikson perqindjen e kembimit dhe cdo dite hedh/terheq nga tregu sasine e monedhave te teperta/mangut qe prishin perqindjen e kembimit te fiksuar si objektiv.....
- **Bullgaria** – leva me euron
- **Maqedonia** – dinari me euron
- **Kina** – yen me disa monedha (euro, dollar, sterlina, yen japonez);
- **Rusia** – rubla me dolarin;
- **“Etaloni – ar”** ... **mbajtja e paritetit te monedhes ne ar nepermjet nje perqindje kembimi fikse**.....

....fiksuar ne 1946 ne Bretton Woods ...braktisur ne 1971 nga Presidenti Nixon...

Politikat Monetare



Rregjimi i kembimit fiks (currency board)ne kete rast relativisht ekstrem, banka qendrore e bashkon/lidh teresisht vleren e emonedhes se saj me nje monedhe tjeter reference, per gjithesishit dollarin amerikan. ...ose nje monedhe tjeter e konsideruar si stabel;

- **Banka qendrore nuk disponon asnje mundesi qe te ndermare nje politike monetare ne funksion te nevojave te ekonomise se saj....**
- **Ky variant i fiksimit te perqindjes se kembimit lejon qe te "importohet" kredibiliteti i monedhes se huaj tek monedha vendase.....Zakonisht kjo mase merret ne kushtet e fenomenit te hiperinflacionit.....**
- **Aktualisht Hong Kongu (me dollarin qe prej 1983); Estonia (me marken gjermane dhe tani me euron); Argjentina (me dollarin, 1990-2001), etj.**



B. Percaktimi i nivelit te rritjes se aggregateve monetare

- **Mbas zhvillimit te teorise monetariste ne vitet 1970....shume vende adoptuan nje politike monetariste te bazuar ne percaktimin e mases se rritjes se aggregateve financiare**
- **Ne nje optike monetariste...masa monetare duhet te rritet me te njejin rritem te PBB.....duke e kontrolluar/ percaktuar ne kete menyre masen monetare mund te mbahet nen kontroll INFLACIONI.....**
- **Kjo lloj politike po perdoret gjithnje e me pak....sepse ajo shkakton nje volatilitet te madh te perqindjeve te interesit.....**

Politikat Monetare

c. Kontrolli/objektivi i Inflacionit

- *Kontrolli i inflacionit eshte nje politike qe synon mbajtjen e inflacionit sipas nje objektivi te fiksuar..... Banka Qendrore mund te fiksoje :*
- **nje objektiv fiks te inflacionit, p.sh., 3%**
- **nje interval te pranueshem te inflacionit, p.sh., 2-4%**
- **nje objektiv fiks, shoqeruar me nje zone te lejuar manovrimi, p.sh., 3% +/- 1%.**



Politikat Monetare

Mbrojtesit e strategjise se kontrollit/fiksimit te inflacionit evidentojne disa avantazhe :

- a. **orienton agjentet ekonomike ne raport me inflacionin –**
- b. **kontribon ne stabiliteten e cmimeve ne periudha afatmesme dhe afatgjata dhe limiton variacionet e inflacionit;**
- c. **rrit transparencen e bankave qendrore;**
- d. **I jep me shume kohe e mundesi bankave qendrore qe te gjejne menyrat me te mira per te realizuar objektivin e tyre;**

■ Dispozitivi i politikave monetare ka 4 elemente



- A. *Objektivat finale;*
- B. *Objektivat e ndermjetme;*
- C. *Indikatoret;*
- D. *Instrumentet;*

Politikat Monetare

- **I. Objektivat Finale**
- ..jane qellimet **definitive te aplikimit te politikave monetare** – p.sh., stabiliteti i cmimeve, stabiliteti i PBB nominal, niveli i punësimit, rritja ekonomike, etj.....
- Ne fund te viteve 1970-të, **objektivi i stimulimit te rritjes ekonomike filloi te braktisej...** dhe politikat monetare ne vendet e OCDE u perqendruan me shume në luften kundër inflacionit dhe ruajtjes se fuqisë blerëse të monedhave...
- **Kujdes!!!.....**
- Bankat Qendrore dhe politikat monetare **nuk mund ti realizojne direkt keto objektiva** sepse ato nuk kane kontroll direkt mbi to...por **nën veprimin e politikave monetare ...rezultatet mund te shihen pas një periudhe 12-18 muajsh.....**

Politikat Monetare

- **II. Objektivat e ndërmjetëm**
- Realizimi i objektivave finale kerkon fiksimin e disa objektivave te ndermjetme tek te cilart instrumentet monetare veprojne me direkt sic jane :
 1. rritja e mases monetare,
 2. madhesia e perqindjes se kembimit,
 3. stabiliteti i perqindjes se kembimit, etj.,

keto lloj objektivash nuk kane vlere ne vetvehte, por ato duhet **te realizohen ne funksion te objektivave finale..... ato jane me te kontrollueshme dhe ecuria e tyre duket me shpejt..**

■ INDIKATORET

- **agregatet monetare, M1,M2,M3; M4;**
- **treguesit e kredise;**
- **perqindja e interesit;**
- **perqindja e kembimit;**
- **cmimi i aktiveve te bankave;**
- **Niveli inflacionit;**
- **Indeksi i ecurise cmimeve;**
- **Rezerva valutore;**



Politikat Monetare

■ INSTRUMENTET

- **Bankat Qendrore kane ne dispozicion 2 instrumente direkte per te realizuar politikat monetare :**
- **1. Veprimin mbi likuiditetet Bankare** – nepermjet se ciles Banka Qendrore vepron ndaj Bankave te nivelist te dyte duke i “*ushqyer*” ato me sasine e nevojshme te monedhave/likuiditetit.....duke modifikuar perqindjen e rezervave te detyrueshme....
- **2. Veprimi me tre llojet e perqindjeve baze qe ajo kontrollon** : kreditimin e bankave, lehtesimin e depozitave, operacionet ne treg;.....veprimi me keto instrumente orienton dhe sjelljen e bankave te nivelist te dyte.....

Politikat Monetare

- Kanalet e transmetimit te politikave monetare
- **1. Kanalet e perqindjes baze te interesit;**
- Nenkupton mekanizmin nepermjet te cilit, ndryshimi i normes baze te interesit përcohet ne normat e interesit te kredive dhe depozitave....
-si dhe mekanizmi nepermjet te cilit normat e reja te interesit te tregut ndikojne vendimetper shpenzime apo investime te bizneseve dhe individeve...



■ **2. Kanali i kreditit;**

- ..konsiderohet si nje kanal perforcues qe amplifikon kanalin e normes baze te interesit;
- Kanali i kredise vepron nepermjet kanalit te huadhenies bankare dhe kanalit te bilancit;
- Politika monetare ekspansioniste rrit rezervat de depozitat bankare si dhe sasine dhe cilesine e kredive...ritja e kredive con ne rritjen e investimeve, punesimit dhe prodhimit....
- Gjithashtu...politika monetare ekspansioniste rrit kapitalin neto dhe flukset e kapitalit te huamarresve.....
- Ne cdo rast....nje kreditim i larte do te sillte investime me te medha dhe prodhim me te larte (Mishkin)

Politikat Monetare

- **3. Kanali i vleres/cmimit te aktiveve;**
- Tregon inpaktin e politikes monetare mbi cmimet e aktiveve te tilla si : aksione, obligacione, pasuri te patundshme, investime kapitale, etj.
- Vepron nepermjet ndryshimeve ne vleren e tregut te bizneseve dhe ne pasurine e individeve...ne vendimet e tyre per investime apo konsum

Politikat Monetare

- **4. Kanali i kursit te kembimit;**
- Ndryshimet e normes baze te interesit ndikojne ne kursin e kembimit..i cili tregon vleren e monedhes vendase ne raport me valutat e huaja...
- ..ai mund te ndikohet si nga normat e huaja te interesit ashtu edhe nga ato vendase...
- (vleresimi/nenvleftesimi i monedhes vendase..ndikimi ne import/eksportet.... ne inflacionin e eksportuar/importuar.... ndikimi ne bilancet e bizneseve/konsumatoreve me borxhe apo depozita ne valute te huaj....

Politikat Monetare

- **5. Kanali i informacionit;**
 - Botimi per publikun e gjere te deklarates se politikes monetare dhe vendimmarrjen e saj;
 - Botimi i diskutimeve/procesverbali i mbledhjes se Keshillave Mbikqyrese te Bankave Qendrore;
 - Deklarata publike e konferanca per shtyp te Guvernatoreve te BQ;
 - Botime e studime te ndryshme mbi politikat monetare dhe efektet e tyre